



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 191/4 prot.

Tiranë, më 29.4.2025

V E N D I M

Nr.19, datë 29.4.2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË,
GJATË ZHVILLIMIT TË PROCESIT TË ECURISË DISIPLINORE SI DHE
PROCESIT TË VLERËSIMIT TË REZULTATETEVE NË PUNË PËR
PERIUDHËN KORRIK-DHJETOR 2024 NË INSTITUCIONIN E AUTORITETIT
KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM),
INSTITUCION NË VARËSI TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, i ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacionit të regjistruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 191 prot., datë 13.2.2025, të dërguar nga nëpunësja civile *Entela Xhakollari*,

VËREJ SE:

Në përmbajtje të informacionit të dërguar pranë Komisionerit nga nëpunësja *Entela Xhakollari*, pretendohet se janë lejuar parregullsi në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në drejtim të procedurës së ndjekur nga Komisioni i Disiplinës, për dhënien e masës disiplinore “Pezullimin nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 2 vjet”, si dhe gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik - Dhjetor 2024, të realizuar nga titullari i institucionit, për këtë punonjëse.

Aktet që materializohen në dokumentacionin e administruar nga Komisioneri, vërtetohet se nëpunësja *Entela Xhakollari*, është emëruar në pozicionin “Drejtore në Drejtorinë

Ekonomike, Shërbimeve të Brendshme dhe Informacionit”, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM), nëpërmjet aktit të emërimit nr. 4 (nr. 6 prot.), datë 5.1.2022, të titullarit të institucionit (në vijim të shkresës nr. 72299 prot., datë 28.12.2021 të Departamentit të Administratës Publike, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë).

Rezulton se me shkresën nr. 9645 prot., datë 10.12.2024, “*Propozim për dhënie mase disiplinore për nëpunësin zbatues të AKSEM*”, Drejtoria e Auditimit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MEI), në përfundim të një procesi auditimi, ka kërkuar fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore për nëpunësin zbatues të AKSEM, me motivacionin: mospërbushje e detyrave, për arsye të mos respektimit të përgjegjësisë të përcaktuara në dispozitat ligjore përkatëse.

Në mbështetje të kësaj kërke, institucioni ka ngritur Komisionin e Disiplinës, i cili në përfundim të procedurës së ecurisë disiplinore, me vendimin nr. 99/19 prot., datë 31.1.2025, ka vendosur dhënien e masës disiplinore: “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 2 vjet*”, për nëpunësen Entela Xhakollari.

Nëpunësja pretendon se, ky akt, ka dalë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, pasi gjatë vendimmarrjes, Komisioni nuk ka marrë parasysh rrethanat dhe faktet e çështjes, në observacionet e paraqitura prej saj. Po kështu, nëpunësja ka pretendime edhe për ndërtimin e Komisionit të Disiplinës, pasi arsyeton se ky organ, nuk është krijuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë disiplinën në shërbimin civil.

Nga ana tjetër, nëpunësja ngre pretendime edhe për parregullsi të lejuara nga zyrtarët vlerësues, gjatë aplikimit të institutit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësit civil, e konkretisht, për vlerësimin e saj për periudhën Korrik - Dhjetor 2024, në nivelin 3 “*kënaqshëm*”.

Në këto kushte, nëpunësja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit, me detyra specifike gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil dhe institutit të vlerësimit të rezultateve në punë.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me informacionin e dërguar nga nëpunësja E. Xhakollari, ku paraqiten rrethana që janë evidentuar më sipër, në mbështetje të kompetencave ligjore të sanksionuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka filluar kryesisht procesin e verifikimit të tij dhe nëpërmjet shkresës nr. 191/1 prot./1 prot., datë 3.3.2025 “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin paraprak të informacionit të administruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 191 prot.*,”

datë 20.2.2025”, ka vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit paraprak të këtij rasti, duke i kërkuar edhe dokumentacionin në të cilin është materializuar ajo.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, institucioni i AKSEM, me shkresën nr. 485/1 prot., datë 7.3.2025, me objekt: *“Dorëzim i dokumentacionit në lidhje me verifikimin paraprak të informacionit”*, protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr. 191/2 prot., datë 27.2.2025, ka dërguar dokumentacionin e plotë në të cilin materializohet procedura disiplinore e ndjekur në këtë rast, si dhe hapat e ndjekur në lidhje me procesin e vlerësimit individual të punës për punonjësen në fjalë, për periudhën Korrik-Dhjetor 2024. Pas analizës dhe verifikimit të dokumentacionit të mësipërm rezulton se:

A. Në lidhje me pretendimin për parregullsi në drejtim të zhvillimit të procesit të ecurisë disiplinore:

Në përfundim të kontrollit të ushtruar (*auditimit*), në zbatim të planit vjetor të veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm në MIE për vitin 2024, grupi i kontrollit ka konstatuar të meta dhe parregullsi që çënojnë funksionimin e komponentëve të kontrollit të brendshëm, kryesisht në rolin e nëpunësit zbatues të institucionit, të cilat i ka evidentuar në Raportin Final të Auditimit (*Dërguar institucionit me shkresën nr. 5376/6 prot., datë 5.11.2024, “Reagim mbi misionin e auditimit të brendshëm”*).

Referuar sa më sipër, Sekretari i Përgjithshëm i MIE, me shkresën nr. 9645 prot., datë 10.12.2024 *“Propozim për dhënie mase disiplinore për nëpunësin zbatues të AKSEM”* drejtuar institucionit AKSEM, ka kërkuar fillimin e procedurave për dhënie të masës disiplinore për nëpunësin zbatues të AKSEM, znj. E. Xhakollari, me detyrë *“Drejtor Ekonomik, Shërbimeve të Brendshme dhe Informacionit”*.

Mbështetur në këtë kërkesë, si dhe në respektim të pikës 1, të udhëzimit nr. 1 datë 2.4.2014, të DAP, (*pavarësisht faktit se është shfuqisuar me udhëzimin nr. 1 datë 21.1.2025, në momentin e fillimit të procedimit disiplinor ka qenë akoma në fuqi, në këto kushte e gjithë analiza do të bëhet mbi këtë bazë ligjore*), Titullari i institucionit, në cilësinë e eprorit direkt, me marrjen dijeni për rekomandimet e mësipërme dhe pasi ka vlerësuar situatën e krijuar me aktin nr. 2316/1, datë 13.12.2024 *“Vlerësim propozimit për dhënie mase disiplinore për nëpunësin zbatues të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera”*), si dhe duke e konsideruar si shkelje të rëndë, në respektim të nëndarjes A, të udhëzimit, ka iniciuar fillimin e procedimit disiplinor për punonjësen E. Xhakollari.

Më tej, Titullari i institucionit, me shkresën nr.2316/3 prot., datë 20.12.2024 *“Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor për nëpunësin zbatues”*, ka njoftuar nëpunësen E. Xhakollari, për fillimin e procedimit duke dërguar bashkëlidhur edhe aktet që e provojnë shkeljen disiplinore. Nga analiza e dokumentacionit u konstatua se, punonjësja ka marrë njoftimin me vonesë, në datën 9.1.2025.

Provohet fakti se, Komisioni Disiplinës është ngritur me Urdhrin e Brendshëm nr. 562 (nr.2316/2 prot.) datë 13.12.2024 “Për krijimin dhe mbledhjen e Komisionit të Disiplinës” dhe në përmbajtje të aktit janë përcaktuar vetëm pozicionet e punës të anëtarëve të KD. Ndërkohë, nëpërmjet shkresës nr. 2316/4, datë 27.12.2024 “Caktim përfaqësuesi”, titullari i institucionit, i ka kërkuar DAP, caktimin e përfaqësuesit të tij si anëtar të Komisionit të Disiplinës dhe ky i fundit me autorizimin nr. 141/1 prot., datë 13.01.2025 ka caktuar znj. Xhuliana Murati për të marrë pjesë si anëtare e KD, (vërtetohet se me e-mailin e datës 15.01.2025, Znj. Murati, ka kërkuar nga institucioni të njihet me dokumentacionin plotësues të procedimit disiplinor). Sipas kronologjisë së akteve, me urdhrin e brendshëm nr. 31, datë 16.1.2025 “Për krijimin dhe mbledhjen e Komisionit të Disiplinës”, i ndryshuar me urdhrin e brendshëm nr. 44 (nr. 99/9 prot.), datë 23.1.2025 “Për një ndryshim/zëvendësim në urdhërin nr. 31 (99 prot.), datë 16.01.2025, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor””, të titullarit të institucionit, janë përcaktuar anëtarët e Komisionit Disiplinor, të cilët janë:

- Alfred Kala – Nëpunësi më i lartë civil në institucion – Kryetar (emëruar me urdhrin nr. 82 (438 prot.) datë 7.10.2013)
- Rrapush Tola – Anëtar, eprori direkt i nëpunësit për të cilin ka filluar procedura, (urdhër nr. 23 datë 30.4.2013, për emërim në detyrë);
- Jonida Balla – Anëtar në cilësinë e drejtuesit të njësisë së burimeve njerëzore (emëruar me urdhrin nr. 94 prot., datë 17.10.2013);
- Xhuljana Murati – Përfaqësuesi i DAP, (Autorizimi nr. 141/1 Prot., datë 13.01.2025 nga DAP).
- Artan Saliu – Anëtar, nëpunësi më i vjetër civil në institucion (emëruar me urdhrin nr.129, datë 17.12.2013)

Nga verifikimi i akteve të emërimit në pozicionin e punës, për secilin anëtar, rezulton se, përbërja e Komisionit është e rregullt, e po ashtu edhe ligjshmëria e ndërtimit të këtij mekanizmi, në raport me kërkesat e pikës 2, të kreut I, “Organet disiplinore”, të vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, i ndryshuar. Sipas kërkesave ligjore, vërtetohet se bashkëlidhur aktit për ngritjen e KD, gjenden edhe aktet e deklarimit të paanshmërisë për secilin anëtar të komisionit, të nënshkruara në datën 16.1.2025.

Në vijim të procedurës disiplinore, nëpërmjet urdhrit të brendshëm nr. 32 (nr. 99/1 prot.), datë 16.1.2025, të titullarit të institucionit është caktuar që seanca dëgjimore për të shqyrtuar shkëljen e pretenduar ndaj nëpunëses E. Xhakollari, të zhvillohet në datën 23.1.2025, në orën 11:00, pranë zyrave të AKSEM, njoftuar nëpunëses me shkresën nr. 99/3 prot., datë 16.1.2025 “Njoftim për caktimin e datës së zhvillimit të seancës dëgjimore”.

Rezulton e dokumentuar se, përfaqësuesi i burimeve njerëzore, njëkohësisht anëtar i KD, i caktuar edhe në rolin e Sekretariatit Teknik të KD, (sipas Urdhërit nr. 33 (nr. 99/2 prot., datë 16.01.2025, të titullarit të institucionit), e ka njoftuar edhe me e-mail-in e datës 17.1.2025, nëpunësen në procedim.

Njëkohësisht, në aktet që materializojnë procesin u konstatua se, të gjithë anëtarët e KD janë njoftuar individualisht me shkresë, për datën dhe orën e zhvillimit të seancës dëgjimore.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 23.1.2025, për shqyrtimin e shkeljes disiplinore, rezulton se, nëpunësja në procedim ka qenë prezent dhe nuk ka shprehur pretendime për përbërjen e KD (vërtetuar me procesverbalin e mbajtur gjatë mbledhjes nr. 99/10 prot., datë 23.1.2024), si dhe i ka paraqitur organit disiplinor sqarimet rreth shkeljes së pretenduar (Observacion nr. 99/8 prot., datë 23.1.2025, material i administruara pranë Komisionerit si nga nëpunësja, ashtu edhe nga institucioni AKSEM).

Në përfundim të kësaj seance dëgjimore, në mënyrë unanime anëtarët KD, kanë arritur në përfundimin se, shkeljet që pretendohet se janë kryer nga nëpunësja, i plotësojnë kushtet për klasifikimin në shkelje të disiplinës në shërbimin civil që trajtohen nga Komisioni i Disiplinës, e në këto kushte, është vendosur fillimi i procedimit disiplinor (vendimi nr. 99/11 datë 23.1.2025, i miratuar nga të gjithë anëtarët e KD).

Në vazhdim të procedurës, me vendimin nr. 99/13 prot., datë 28.1.2015, të kryetarit të KD, është caktuar që, Komisioni Disiplinor të mbledhet në datën 31.1.2025, ora 12:00, për marrjen e vendimit përfundimtar mbi procesin disiplinor. Me shkresë të veçantë janë njoftuar të gjithë anëtarët e Komisionit.

Sipas këtij vendimi, KD është mbledhur në datën 31.1.2025 për të marrë vendimin përfundimtar në lidhje me procedimin disiplinor në ngarkim të nëpunëses E. Xhakollari dhe mbledhja është pasqyruar në procesverbalin e mbledhjes, të regjistruar me nr. 99/18 prot., datë 31.1.2025.

Nga përmbajtja e procesverbalit rezulton se, katër anëtarë të Komisionit Disiplinor kanë votuar për dhënien e masës disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, ndërsa një anëtar (përfaqësues i DAP) ka votuar për dhënie të masës disiplinore “Vërejtje”.

Duke qenë në kushtet e vendimit të shumicës së anëtarëve të KD, anëtari përfaqësues i DAP, në përputhje me kërkesat e nenit 17, të ligjit nr. 8480/1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ka dhënë edhe mendimin e tij të mbetur në pakicë, duke argumentuar se:

“Konstatohen parregullsi të natyrës administrative në kryerjen e detyrave funksionale nga ana e znj. Xhakollari, por nuk konstatohet mospërbushje detyrash nga ana e nëpunëses, si rrjedhim vlerësoj se shkeljet e pretenduara në ngarkim të nëpunëses nuk mund të klasifikohen në një nga rastet e shkeljeve të rënda.

Referuar provave të administruara, të marra në shqyrtim nga Komisioni Disiplinor, nuk rezulton që znj. Xhakollari të ketë kryer shkelje flagrante të ligjit....”.

Komisioni i Disiplinës, duke patur shumicën e tij në vendimarrje, me vendimin nr. 99/19 prot., datë 31.1.2025, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për nëpunësen Entela Xhakollari.

Vendimi i Komisionit të Disiplinës i është njoftuar nëpunëses me shkresën nr. 99/21 prot., datë 7.2.2025, njëkohësisht edhe Departamentit të Administratës Publike me shkresën nr. 99/22 prot., datë 7.2.2025.

Nisur nga përmbajtja e dokumentacionit në të cilin materializohet procedura disiplinore, arrihet në konkluzionin se, nga pikëpamja procedurale janë respektuar të gjitha kërkesat e ligjit, duke filluar nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore; kërkesës për fillimin e ecurisë; vënies në dijeni për këtë fakt të nëpunëses që pretendohet se ka kryer shkeljen; respektimi i të drejtës për t’u dëgjuar, e për t’u mbrojtur; dhe administrimi i provave materiale të nevojshme, e deri në marrjen e vendimit përfundimtar për dhënien e masës disiplinore, që e përfaqëson akti nr. 99/19 prot., datë 31.1.2025, i nxjerrë me shumicë votash nga ana e Komisionit të Disiplinës.

Në këto kushte, arrihet në përfundimin se, akti për dhënien e masës disiplinore në ngarkim të nëpunëses E. Xhakollari, është kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për nëpunësin civil, duke respektuar procedurat që parashikohen gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil.

B. Në lidhje me pretendimin për parregullsi të lejuara nga titullari i institucionit, gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik - Dhjetor 2024:

Nga analiza e materialeve të dërguara nga institucioni, konstatohet se, procesi i vlerësimit të punës për periudhën Korrik-Dhjetor 2024, është zhvilluar duke zbatuar të gjitha kërkesat procedurale e materiale të parashikuara nga legjislacioni i shërbimit civil, konkretisht:

Në bazë të pikës 2, të kreut II, të VKM-së nr. 109, datë 26.2.2014, i ndryshuar, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të konfirmuar, është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, brenda vitit kalendarik dhe duhet të respektohen të gjitha fazat e këtij

procesi të parashikuara në pikën 12, kreu II, i VKM-së nr. 109, datë 26.2.2014, i ndryshuar, të evidentuara si më poshtë:

- Planifikimi: Zyrtari i raportues, përcakton objektivat kryesorë të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në fazën e planifikimit përfshihet përgatitja e objektivave dhe e një plani veprimtarish për arritjen e objektivave kryesore. Objektivat kryesorë të punës duhet të jenë të matshëm, kurse veprimet të dukshme. Në këtë fazë zyrtari raportues dhe nëpunësi që do të vlerësohet diskutojnë së bashku qëllimet e nëpunësit për karriere, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.

Kjo fazë është realizuar dhe dokumentuar me aktin nr. 1032 prot., datë 5.7.2024 “*Objektivat e nëpunësve civilë të Drejtorit të Inspektimit, Drejtorit të Emergjencave dhe Shpëtimit në Miniera dhe Drejtorit Ekonomik, Shërbimeve të Brendshme dhe Informacionit, për vitin 2024*”, si dhe me caktimin e kohës për të zhvilluar takimin e ndërmjetëm midis Drejtorit Ekonomik, Shërbimeve të Brendshme dhe Informacionit dhe titullarit të institucionit, konkretisht në datën 1.10.2024 (sipas aktit nr. 1047 prot., datë 5.7.2024).

- Bisedimet e ndërmjetme: në mes të periudhës së vlerësimit, Zyrtarët raportues takohen me secilin prej nëpunësve që do të vlerësohet për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë komente, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.

Rezulton se, me aktin nr. 1047/1 prot., datë 1.10.2024, është realizuar takimi për zhvillimin e bisedimeve të ndërmjetme, ku janë sqaruar dhe janë dhënë komentet për të gjitha fazat e vlerësimit, takimi është finalizuar me nënshkrimin e aktit nga ana e të dy pjesëmarrësve në proces.

- Vlerësimi përfundimtar: ka të bëjë me vlerësimin e përmbledhur të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen e objektivave kryesore të punës, duke respektuar afatet e vlerësimit.

Konstatohet se, formulari i vlerësimit është plotësuar në gjitha rubrikat e tij dhe nënshkruar nga të gjithë personat përgjegjës të ngarkuar nga ligji me detyrat e administrimit të shërbimit civil, njëkohësisht edhe nëpunësi i vlerësuar ka shprehur dakordësinë me vlerësimin e dhënë, duke nënshkruar në rublikën përkatëse.

Nisur nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se, procesi i vlerësimit të nëpunësës Entela Xhakollari, për periudhën Korrik- Dhjetor 2024, është një proces administrativ i rregullt, i kryer në përputhje me kërkesat procedurale të përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, për vlerësimin e nëpunësve civilë.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes së filluar në bazë të informacionit nr. 191 prot., datë 20.2.2025, të paraqitur nga nëpunësja Entela Xhakollari, e cila ushtron detyrën pranë institucionit të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM), institucion në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MEI), me objekt:
 - a) vlerësimin e ligjshmërisë, së veprimeve administrative të kryera nga eprori direkt dhe Komisioni i Disiplinës, gjatë procesit të ecurisë disiplinore, në ngarkim të saj;
 - b) vlerësimin e ligjshmërisë gjatë veprimeve të kryera nga titullari i institucionit, gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik - Dhjetor 2024, për punonjësen Entela Xhakollari, në kushtet kur në veprimet e kryera nga ana e subjekteve të ngarkuara me detyra të veçanta gjatë administrimit të shërbimit civil, nuk konstatohen elementë që vijnë në kundërshtim me legjislacionin që rregullon sistemin e shërbimit civil.
2. Të njoftohet për këtë vendim Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM), në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MEI); Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja Entela Xhakollari.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha